



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 janar 2013
Nr. ref.: RK338/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI39/11

Parashtruesi

Tomë Krasniqi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Njoftimit Nr. 311/07, të 13 prillit 2007, dhe
Vërtetimit Nr. 322/07, të 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe
Mirëqenies Sociale**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Tomë Krasniqi, pensionist, me banim në Prishtinë.

Vendimet e kontestuara

2. Njoftimi Nr. 311/07, i 13 prillit 2007, dhe Vërtetimi Nr. 322/07, i 30 prillit 2007, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, nenet 20, 22.7 dhe 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes ka të bëjë me humbjen e statusit të pensionistit, përkatësisht me ndërprerjen e pagesave të pensionit që i kishte fituar parashtruesi me Aktvendim të plotfuqishëm Nr. 181 – 1/98, të 11 qershorit 1998, nga Fondi për Sigurimin Pensional e Invalidor të Kosovës në Prishtinë.

Procedura në Gjykatë

5. Më 16 mars 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 18 prill 2011, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-39/11, caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-39/11, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 6 korrik 2011, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.
8. Më 4 gusht 2011, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale u përgjigj përkitazi me kërkesën e parashtruesit.
9. Më 14 tetor 2011, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë një shkresë që përmbante interpretimin juridik të së "drejtës së fituar" të titulluar "E DREJTA E FITUAR NË PENSION DHE SIGURIA JURIDIKE E SAJ".
10. Më 19 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI-39/11, caktoi gjyqtarin Altay Suroy Gjyqtar raportues, pas përfundimit të mandatit të gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj si gjyqtare e Gjykatës. Të njëjtën datë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI-39/11, caktoi Kolegjin shqyrtues të ri, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
11. Më 27 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës, në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Historiku i kërkesës

12. Më 3 maj 1998, parashtruesit i është pranuar e drejta në shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë.
13. Më 11 qershor 1998, parashtruesi, me Aktvendim të plotfuqishëm Nr. 181-1/98 të Fondit për Sigurimin Pensional dhe Invalidor të Kosovës, fitoi statusin e pensionistit.

14. Parashtruesi, me punë dhe mbi bazën e punës së kaluar, në pajtim me legjislacionin në fuqi nga marrëdhënia e punës, sipas parimeve të solidaritetit dhe të reciprocitetit, në përputhje me Ligjin për Sigurimin Pensional e Invalidor, me sigurim të detyrueshëm fitoi të drejtën për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë. Parashtruesi fitoi të drejtën në fjalë në Bashkësinë rajonale të Fondit për Pensionim të Kosovës në Prishtinë.
15. Parashtruesi ka gëzuar të drejtën e fituar për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë deri në nëntor të vitit 1998, mirëpo, për shkak të rrethanave të krijuara në Kosovë, në fillim të vitit 1999, e drejta e parashtruesit për shfrytëzimin e pensionit të pleqërisë ishte ndërprerë pa kurrfarë baze ligjore.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën administrative

16. Më 11 prill 2007, parashtruesi dorëzoi një ankesë në Departamentin e Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DAPK), në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: Ministria), përkitazi me statusin e tij si pensionist, që parashtruesi e kishte fituar me Aktvendimin e plotfuqishëm Nr. 181-1/98, të 11 qershorit 1998, nga Fondi për Sigurimin Pensional e Invalidor të Kosovës.
17. Më 13 prill 2007, DAPK-ja lëshoi njoftimin me numër Ref. 311/2007 dhe, *ndër të tjera*, informoi parashtruesin se problemi i mospagesës së pensioneve të fituara në bazë të kontributeve paraqet një ndër problemet politike, tash për tash të pazgjidhura.
18. Më 30 prill 2007, DAPK-ja lëshoi vërtetimin Nr. 322/07 që, *ndër të tjera*, theksonte se parashtruesi i kërkesës figuron në evidencën për pagesën e pensionit të fituar në bazë të kontributeve nga Sigurimi Pensional e Invalidor në Prishtinë prej vitit 1998 e tutje.
19. Më 24 janar 2008, parashtruesi kishte paraqitur kërkesë në Ministri (DAPK) për njohjen e të drejtës së tij në pension, bazuar në kontributet e paguara.
20. Më 11 shtator 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Nr. 280/09, urdhëroi Ministrinë (DAPK-në) ta njohë të drejtën e parashtruesit si pensionist kontributpagues.
21. Më 23 shtator 2009, derisa procedura ishte në zhvillim e sipër në Gjykatën Supreme të Kosovës, Ministria (DAPK), me Vendimin 104474, njohu të drejtën e parashtruesit si kontributpagues në shumë mujore 35 €, duke cekur gjithashtu në këshillë juridike se parashtruesi mund të ankohej kundër vendimit të Ministrisë (DAPK-së) brenda 15 ditësh nga dita e pranimin të vendimit të Këshillit të ankesave në DAPK.
22. Më 19 nëntor 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktvendimin A. 837/2009, ka kërkuar nga paditësi (parashtruesi) që, në afatin 15-ditësh nga dita e marrjes së Aktvendimit të të paditurës (Ministrisë-DAPK-së) Nr. 280/09, të datës 11 shtator 2009, të deklarohet se a është i kënaqur me vendimin, ose nuk heq dorë nga padia. Parashtruesi ishte njoftuar se, nëse nuk vepron sipas Aktvendimit, Gjykata Supreme e Kosovës do ta pezullojë procedurën.
23. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 837/2009, pezulloi procedurën, duke theksuar, *ndër të tjera*, si vijon:

“Aktvendimi i Gjykatës Nr. 9/2009, datë 01 qershor 2010, paditësit (Parashtruesit) i është dorëzuar më 27 nëntor 2010. Paditësi nuk është deklaruar në afatin e caktuar me aktvendim.

Meqë paditësi (Parashtruesi) në afatin e lënë nuk është deklaruar, Gjykata në përputhje me nenin 32. par 1 të LPK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi”.

24. Më 4 gusht 2011, Ministria (DAPK) iu përgjigj Gjykatës përkitazi me kërkesën e parashtruesit, duke cekur, *ndër të tjera*, se parashtruesit të kërkesës i janë njohur të drejtat si shfrytëzues i pensionit bazë dhe pensionit kontributpagues dhe se çështja e pensioneve nga fondi i ish-Federatës Jugosllave mund të zgjidhet vetëm pas negociatave ndërshtetërore.

Përmbledhja e fakteve përkitazi me procedurën civile

25. Më 4 maj 2007, parashtruesi paraqiti padinë C. nr. 1155/07 në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër Qeverisë së Kosovës, përkatësisht kundër Ministrisë (DAPK-së), duke kërkuar rikthimin e statusit të pensionistit kontributpagues dhe kompensimin e shumave nga pensionet e arritura dhe të paguara në vlerë 18.360 €.
26. Më 14 janar 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e parë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë C. nr. 1155/07, të datës 4 maj 2007.
27. Më 16 qershor 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e dytë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë C. nr. 1155/07, të datës 4 maj 2007.
28. Më 17 dhjetor 2008, parashtruesi paraqiti urgjencën e tretë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për të thirrur seancë gjyqësore përkitazi me padinë.
29. Më 9 janar 2009, parashtruesi paraqiti parashtrësë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me ç'rast kërkoi nga gjykata në fjalë që të konstatojë se parashtruesi ka statusin e pensionistit me të drejta të plota që nga data 1 dhjetor 1998 e tutje, mbi bazën e kontributeve të paguara nga ai për 40 vjet stazh pune.
30. Për më tepër, parashtruesi, mbi bazën e parashtrësës së lartpërmendur, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë që të obligojë Republikën e Kosovës, gjegjësisht Ministrinë (DAPK-në), si palë të paditura, t'i paguajnë pensionet e arritura prej 1 dhjetorit 1998 deri në paraqitjen e padisë, në vlerë 18.360 €, dhe nga muaji maj i vitit 2007 t'i paguajnë atij shumën 180 € në muaj, derisa ai ka të drejtë në këtë pagesë, si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afatin 15-ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
31. Më 28 qershor 2010, parashtruesi paraqiti një tjetër parashtrësë në Gjykatën Komunale në Prishtinë, me ç'rast kërkoi përshpejtimin e procedurës gjyqësore dhe caktimin e seancës kryesore përkitazi me lëndën e tij, sepse prej dorëzimit të kërkesëpadisë kishin kaluar më shumë se 3 (tri) vjet.

Procedura në institucionet e tjera

32. Më 30 shtator 2009, Institucioni i Avokatit të Popullit, pas kërkesës së parashtruesit, kërkoi nga Gjykata Komunale në Prishtinë që të informohet për veprimet e ndërmarra dhe ato që planifikohen të ndërmerreshin nga gjykata në fjalë përkitazi me padinë e parashtruesit.
33. Gjykata Komunale në Prishtinë iu përgjigj kërkesës së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke nënvizuar se ka pranuar padinë nga parashtruesi i kërkesës, si dhe përgjigjen e palës së paditur dhe se do të procedojë tutje me këtë çështje sipas radhës së lëndëve të arritura në atë Gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit

34. Parashtruesi mëton shkelje të nenit 1(2) [Përkufizimi i Shtetit]; të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]; të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24(1) [Barazia para Ligjit]; të nenit 31 (1) [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 32 [E drejta për Mjete Juridike]; të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës]; të nenit 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 1 [Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut]; me nenin 6(1) [E Drejta për një Proces të Rregullt]; me nenin 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive]; me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 [Mbrojtja e Pronës]; me nenin 1 të Protokollit Nr. 12 [Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit] të Konventës.
35. Parashtruesi mëton se institucionet e Republikës së Kosovës, me veprimet gjegjësisht me mosveprimet e tyre, kanë shkelur dispozitat e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të Konventës në dëm të tij, me ç'rast parashtruesi është diskriminuar dhe i janë mohuar, *ndër të tjera*, e drejta për pronë, e drejta për mbrojtje shëndetësore dhe sociale, e drejta për proces të rregullt dhe e drejta për zgjidhje efektive.
36. Parashtruesi mëton se kërkesa e tij ka të bëjë me interesin e përgjithshëm publik dhe jo vetëm me atë personal. Me interesin e përgjithshëm publik përfshihen pensionistët e të gjitha kategorive (pensionistët e pleqërisë, pensionistët invalidorë dhe pensionistët familjarë).
37. Parashtruesi, në procedurë administrative, ka kërkuar nga e paditura (Ministria-DAPK) që t'ia mundësojë pagesën periodike të pensioneve të arritura e të papaguara dhe t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar, që nga data kur ai mëton se kjo e drejtë i është mohuar. Për realizimin e kësaj të drejte, parashtruesi pohon se ka ushtruar kërkesa dhe ankesa të përsëritura dhe ka marrë përgjigje negative.
38. Përfundimisht, parashtruesi kërkon nga Gjykata:
 - Rikthimin e statusit të humbur të pensionistit të fituar me punë vetjake mbi bazën e punës së kaluar duke paguar kontribute të detyrueshme ligjore gjatë tërë kohës kur e ka gëzuar statusin e të siguruarit;
 - Zhdëmtimin e plotë mbi bazën e kërkesave të arritura e të papaguara (pensioneve), sipas kësteve të pensioneve të arritura e të papaguara prej ditës kur parashtruesit i janë ndërprerë këstet e pensioneve deri në ditën e pagesës së tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
 - Të vendosë në mënyrë meritore për rastin konkret që i referohet interesit ligjor publik;
 - Të vendosë veçanërisht duke zbatuar mekanizmat e mundshëm të drejtësisë nëpërmjet Gjykatës Komunale në Prishtinë, që në cilësinë e gjykatës së rregullt kompetente të realizohet interesi juridik personal i parashtruesit; dhe
 - Të vendosë për njoftimin e parashtruesit dhe të palëve të tjera ndërgjyqësore dhe të palëve të interesuara.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

39. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
40. Sa i përket pohimit të parashtruesit se kërkesa e tij ka të bëjë jo vetëm me të si individ por edhe me interesin e përgjithshëm publik, Gjykata përsërit se Kushtetuta e Kosovës nuk parashihet *actio popularis*, që do të thotë se individët nuk mund të ankohen në abstrakt ose t'i sfidojnë drejtpërsëdrejti veprimet ose mosveprimet e autoriteteve publike. Kushtetuta e Kosovës ofron mbështetje për individët sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon nga parashtruesit të tregojnë se janë: (1) palë të autorizuar, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret ose mosveprimi i autoriteteve publike, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit, për sa i përket interesit të përgjithshëm publik, nuk i plotëson kushtet e lartpërmendura dhe, mbi bazën e këtyre arsyeve, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme (*Shih, Aktvendim për papranueshmëri KI51/10, Ljubisha Zhiviq, Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Kryetarit të Republikës së Kosovës për emërimin e Goran Zdravkoviqit anëtar të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përfaqësim të komunitetit serb, i datës 2 mars 2012*).
41. Parashtruesi ka iniciuar dy procedura pothuajse paralelisht për të rikthyer statusin e pensionistit dhe zhdëmtimin për pensionet e papaguara prej 1 dhjetorit 1998 e deri më tani: (1) procedurën civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë nga 4 maji 2007 dhe që ende nuk është zgjidhur, dhe (2) procedurën administrative nga 11 prilli 2007 në Ministri (DAPK) dhe që përfundoi me Aktvendim të Gjykatës Supreme (A. nr. 837/2009, të 23 shkurtit 2011).
42. Gjykata Supreme, me Aktvendimin A. nr. 837/2009, të 23 shkurtit 2011, pezulloi procedurën administrative në përputhje me nenin 32, paragrafi 1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, pasi që parashtruesi nuk ishte deklaruar brenda afatit të caktuar me aktvendim.
43. Neni 32, paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton:
- "Në qoftë se organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin ndryshohet ose vihet jashtë fuqie akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin nga neni 1 i këtij ligji nxjerr më vonë aktin administrativ, organi, përpos paditësit, do ta njoftojë njëkohësisht edhe gjykatën, para së cilës është ngritur konflikti. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda 15 ditësh të deklarojë nëse me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur ose nuk heq dorë nga padia dhe nëse respektivisht padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër. Në qoftë se paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo në qoftë se nuk e jep deklaratën brenda afatit nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata do të nxjerrë aktvendimin mbi pezullimin e procedurës. Në qoftë se paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën".*
44. Për sa i përket procedurës administrative të iniciuar në Ministri (DAPK) për realizimin e të drejtave të tij, parashtruesi ka konsideruar se ka marrë përgjigje negative dhe, si rrjedhojë, pa përfunduar procedurën administrative, kishte iniciuar procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Megjithatë, sipas vlerësimit të Gjykatës, parashtruesi duhet të provojë pse nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike gjatë zhvillimit të procedurës administrative dhe të tregojë se mjetet juridike që kishte në dispozicion

sipas legjislacionit të Kosovës ishin të pamjaftueshme ose të pafrytshme, ose që ka pasur rrethana të veçanta që lirojnë parashtruesin nga detyrimi për të shteruar mjetet juridike, gjegjësisht për të ndjekur procedurën administrative deri në fund. Dyshimi i thjeshtë i parashtruesit nuk e liron atë nga detyrimi për të shteruar mjetin e caktuar juridik. (Shih, *Epözdemir v. Turqi*, nr. 57039/00, aktvendim i 31 janarit 2002; *Pellegriti v. Itali*, nr. 77363/01, aktvendim i 26 majit 2005; *MPP Golub v. Ukrainë*, nr. 6778/05, aktvendim i 18 tetorit 2005).

45. Për sa i përket rastit në fjalë, parashtruesi nuk ka provuar se procedura administrative, që kishte iniciuar ai, ishte e paefektshme ose e pafrytshme, përveç deklaratës së tij se ka marrë përgjigje negative. Dhe, në të njëjtën kohë, parashtruesi kishte zhvilluar procedurë civile po ashtu kundër Ministrisë (DAPK) në Gjykatën Komunale në Prishtinë, që ishte iniciuar më 4 maj 2007.

46. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

47. Qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është që t'u lejojë autoriteteve publike, përfshirë gjykatat e rregullta, mundësinë për t'i parandaluar ose për t'i korrigjuar shkeljet e supozuara të Kushtetutës. Rregulli i shterimit të mjeteve juridike bazohet në karakterin subsidiar të kornizës procedurale të drejtësisë kushtetuese. (Shih, *Aktvendim për papranueshmëri: AAB-RINVEST L.L.C., Prishtinë vs. Qeverisë së Republikës së Kosovës*, KI41/09, i datës 21 janar 2010; dhe shih, *mutatis mutandis, ECHR, Selmouni vs. Francë*, no. 25 803/94, vendim i 28 korrikut 1999).

48. Në rastin në fjalë, parashtruesi nuk e ndoqi procedurën administrative deri në fund dhe në mënyrë pothuajse paralele inicioi procedurë civile në Gjykatën Komunale në Prishtinë, pa pranuar vendim përfundimtar në procedurë administrative. Prandaj, parashtruesi ka dështuar të veprojë në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

49. Për më tepër, sa i përket padisë civile të parashtruesit në Gjykatën Komunale të Prishtinës, Gjykata i referohet nenit 31, paragrafi 2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës:

“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

50. Gjykata thekson se dispozita e lartpërmendur kushtetuese parasheh procedurë më të shpejtë në rastet kur individët përballen me akuzë penale, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me padi civile ku Gjykata Komunale në Prishtinë ka marrë përgjigje nga pala e paditur, dhe po ashtu ka theksuar se do të procedojë tutje padinë në fjalë sipas lëndëve të arritura në atë gjykatë.

51. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme, për shkak të moshterjes së mjeteve juridike, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe me nenin 47 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 47 të Ligjit; si dhe në pajtim me rregullin 36.1 (a) të Rregullores së punës, më 27 nëntor 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani